



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 8, datë 16.01.2020

MBI

FILLIMIN E PROCEDURË PËR MIRATIMIN E “KONTRATËS TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE/KESH SH.A, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL/FSHU SHA PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE FUNDORË”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, gërma h, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, neni 5 pika 2 e VKM Nr.244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, neneve 15, 19, pika 1, gërma f dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 16.01.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga Drejtoritë Teknike nr.5/5 prot, datë 13.01.2020, në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e Kontratës tip për shitblerjen e energjise elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/FSHU sh.a për furnizimin e klientëve fundorë.

Konstatoi se:

- ERE, në zbatim të nenit 20 gërma h, të Ligjit Nr. 43/2015, date 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, VKM Nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” i ndryshuar, Vendimit të Bordit të ERE Nr. 112, Datë 08.07.2016, “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”, ngarkohet me detyrimin për miratimin e Kontratës tip për shitblerjen e energjise elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a, aksionet

e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/FSHU sh.a për furnizimin e klientëve fundorë.

- Për sa më sipër parashikuar në VKM 244/2016, të ndryshuar, draftimi i një kontrate tip që të mbulojë më së miri nga pikëpamja ligjore por edhe rregullatore interesat, të drejtat dhe detyrimet e palëve ndaj njëra tjetrës, vjen si domosdoshmëri veçanërisht në fillim të vitit ushtrimor por që lidhet njëkohësisht edhe me bërjen efektive të ndarjes së aktivitetit të OSHEE sh.a., duke ia lënë detyrimin e garantimit të furnizimit në cilësinë e furnizuesit të shërbimit universal, shoqërisë së krijuar dhe tashmë operative që nga 1 janari 2020, FSHU sh.a.
- Në draft kontratë, janë reflektuar edhe ndryshimet e fundit të VKM nr.244/2016 (VKM 883, datë 27.12.2019, ku parashikohet në nenin 5 pika 2 se :*“Ndërmjet furnizuesit të shërbimit universal dhe shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik nënshkruhet kontrata TIP, e miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë, e cila negociohet çdo vit, në lidhje me sasinë e energjisë së siguruar dhe çmimin për njësi, përpara fillimit të çdo viti kalendarik të ushtrimit të aktivitetit”*
- Në kuptim të sa më sipër, janë palët që kanë detyrimin për të negociuar dhe nënshkruar me njëra tjetrën kontratë të rinovuar për çdo vit ushtrimor, në të cilën të reflektohen dispozitat apo ndryshimet e dakortësuara që lidhen ekskluzivisht me elementët çmim dhe sasi.
- Me qëllim përmbushjen e detyrimit për sa më sipër, është draftuar kjo kontratë në frymën e kontratave të dakotësuara më herët edhe mes palëve e të konstatuara në përmbushje të parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe korrespondencat me shoqëritë e ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik, pjesmarrësit e tjerë të tregut të energjisë elektrike, Autoritetin e Konkurrencës dhe Ministrinë e Infrastruktues dhe Energjisë.
- Draft kontrata propozohet e strukturuar në 23 nene dhe një shtojcë të cilat adresojnë çështje që lidhen me përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik nga KESH sha dhe FSHU sh.a, si dhe regullimin e marrëdhënies së shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet Paleve përfshirë në këtë kontratë dhe jo vetëm programimin dhe nominimin e sasive, por edhe marrëdhënien financiare mes tyre.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Kontratës tip për shtiblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/FSHU sh.a për furnizimin e klientëve fundorë.
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI